




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 698, datë 21.11.2018

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.269, DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE
TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT
NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE,
NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE
OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE,
QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit të punës", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës, "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 1, të vendimit nr.269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, pas shkronjës "g" shtohet shkronja "gj", me këtë përmbajtje:

“gj) Përrjashtimisht për vitin akademik 2018-2019, studentët e regjistruar në vitin e parë dhe në vitet pas të parit, në ciklin e parë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimit në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr.1, të vendimit nr.216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019”.

Studentët e regjistruar në vitin e parë, sipas përcaktimeve të kësaj shkronje, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), e përlllogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.

Studentët e regjistruar në vitet pas të parit, sipas përcaktimeve të kësaj shkronje, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), e përlllogaritur si mesatare e notave të të gjitha detyrimeve të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe të shlyera për vitet pararendëse.

Studentët përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit vetëm për periudhën që ndjekin studimet në këto programe studimi dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

LINDITA NIKOLLA

NR.PROT. 5428/1
DATË 23 / 11 / 2018

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

